



Datë: 25.10.2025
Numër Protokolli: 7254/2025

A.nr.1314/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1314/2025, të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesja Q.K, kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1314/2025, të datës 08.07.2025, e parashtruar nga ankuesja Q.K.
- II. **Anulohet** procedura e pranimit numër reference RN00017748, për pozitën e punës *Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2*, të shpallur nga Komuna e Pejës.
- III. **Obligohet** Njësia e Personelit të Komunës së Pejës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative në kuptim të zbatimit të vendimit sikurse është përcaktuar në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 08.07.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër referencë RN00017748, për pozitën e punës *Zyrtar për Buxhet dhe Financa2*, të shpallur nga Komuna e Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjën në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll li 4565/2025, të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.07.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 25.07.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Aplikacionin me datë aplikimi 06.05.2025 të kandidatës V.G së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 23.05.2025 të kandidatës A.K, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Listën përfundimtare nga SIMBNJ të datës 30.06.2025; Njoftimin përfundimtar Nr.01-112/01-00455544/2025, të datës 30.06.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 30.06.2025; Njoftimin për intervistën me gojë të datës 25.06.2025; Çelësin e pyetjeve të intervistës me gojë; Formularët e vlerësimit të esesë me gojë e datës 26.06.2025; Njoftimin për Verifikim Paraprak me Nr.01-112/01-0039956/2025 të datës 10.06.2025; Vendimin Nr.prot.01-112/01-0040451/25, të datës 11.06.2025; Akt emërimit Nr.01-112/0027638/2025, të datës 23.04.2025; Akt emërimit e datës 07.05.2025; Akt emërimit Nr.01-112/01-0064239/22, të datës 14.06.2022; Akt emërimit Nr.01-112/01-0077941/22 të datës 18.07.2022; Akt emërimit Nr.01-112/010106882/23, të datës 01.11.2023; Njoftimin për test me shkrim të datës 18.06.2025; Esenë si dhe çelësin e eses; Vlerësimin e pyetjeve të lira; Konkursin me numër reference RN00017748; Testin me shkrim; Vendimin me numër protokolli 5566/2025 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

- Komuna e Pejës më datë 30.04.2025 ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00017748, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar për Buxhet dhe Financa në Drejtorinë për Arsim, me klasë Profesional 2, një (1) vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 01.05.2025 deri më datën 30.05.2025.
- Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se e njëjta i është nënshtruar vlerësimit profesional përmes tetit më shkrim, ashtu që e njëjta në testin me shkrim ka arrit gjithsejtë 49.6 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazat tjera të vlerësimit, gjegjësisht intervistës me gojë.
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore më datë 30.06.2025, ka publikuar njoftimin përfundimtar Nr.01-112/01-0045554/2025, nga i cili njoftim rezulton se si kandidate e suksesshme për procedurën përkatëse të rekrutimit është shpallur V.G me 96 pikë. Rrjedhimisht, referuar renditjes përfundimtare të datës 30.06.2025, kandidatja V.G ka qenë kandidatja e vetme e suksesshme në këtë procedurë.
- Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin se ka pas parregullsi ne procedurën më nr.refernce RN00017748. Shton së në ditën e testit me shkrim nuk janë kontrolluar dokumentet e identifikimit, nën supozimin se në test ka hyr edhe një person tjetër në vend të kandidatëve të listuar, gjithashtu gjatë testit me shkrim kandidatja fituese ka kopjuar, duke përdor fletë, që sugjeron së ajo i ka pasur pyetjet para kohe, e po ashtu mbarëvajtja e procesit të testit me shkrim nuk është kontrolluar në mënyrë adekuate nga ana e anëtareve të Komisionit. Propozon që ankesa të aprovohet.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit me Nr.ref: RN00017748 dhe si rrjedhojë Kolegji fillimisht ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit të kontestuar ku dhe vërtetoj se si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2 janë përcaktuar:: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Drejtimi Ekonomik, Financa apo Kontabilitet. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillon procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Mbi gjendjen e fakteve si më sipër, konstatohet se grupimi dhe kriteret e përgjithshme formale për pozitën e shpallur kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil dhe së Komisioni i Pranimit i cili ka bërë vlerësimin e kandidatëve në këtë procedurë ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore sipas nenit 40, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ndërsa, në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore Kolegji iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9 par. 1, 2: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përfundimisht, për pozita specifike të zyrtarëve/it publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

-Nenit 39 : 1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përfundimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në

përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar prapun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës...”

Referuar kuadrit ligjor si më sipër Kolegji i Këshillit ka analizuar testin me shkrim të aplikuar për pozitën e kontestuar dhe si rrjedhojë ka gjetur së testi përmbante 25 pyetje me shumë opsione të tipit të kombinuar, me pyetje të përgjithshme dhe me pyetje që ndërlidhen me vendin e punës, dhe po ashtu tema e eses në vlerësimin e kolegjit ndërlidhen me pozitën e shpallur, pra pyetjet e testit kanë qenë përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil, Rrjedhimisht, ankuesja ka dhënë 15 përgjigje të sakta tek pyetjet me shumë opsione, duke grumbulluar 30 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), vlerësim ky që behët nga sistemi elektronik, ndërsa, në ese si vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimit, ankuesja është vlerësuar më 19.6 pikë, nga 20 pikët maksimale, duke arritur gjithsej 49.6 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar më fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: **4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.** Në fakt, Kolegji duke e krahasuar vlerësimin e eses së ankueses me kandidatin e shpallur fituese ka gjetur së Komisioni i pranimit këtë të fundit e ka vlerësuar në ese më vetëm 16 pikë, që nënkupton së kandidatja fitues në ese është vlerësuar më pak se ankuesja, kështu që, në këto rrethana Kolegji nuk verën vlerësim favorizues për kandidaten fituese, e cila edhe pse kishte vlerësim më të ulët në ese, e njëjta tek pyet me disa opsioni ka arritur të grumbull 50 pikë, në total 66 pikë, andaj, meqenëse ankuesja nuk e ka arritur numrin e nevojshme të pikëve në testin me shkrim (se paku 50 pikë) atëherë, e njëjta nuk ka mundur të vazhdojë më intervistën më gojë.

Në kuptim të parimit të meritokracisë, si një parimet themelore në procedurë të pranimit në shërbim civil, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar edhe aplikacionin e kandidates fituese përkitazi me plotësimin e kërkesave të përgjithshme formale të konkursit, ku edhe e ka vërtetuar së kandidatja V.G posedon Diplomën me Nr.833, të datës 22.03.2004, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilin vërtetohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 24.02.2004, në Fakultetin Ekonomik, Drejtimi Menaxhment dhe Informatikë, pra, kandidatja e shpallur fituese nuk i ka plotësuar kriteret formale të përgjithshme për pozitën e kontestuar, sepse, siç u theksua më sipër, si kriter i arsimit lidhur me pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa është përcaktuar Fakulteti Ekonomik, drejtimi Ekonomiks, Financa apo Kontabilitet, ndërsa ankuesja si fushë të studimeve ka programin Menaxhment dhe Informatikë, kështu që, mbi gjendjen e këtyre fakteve dhe rrethanave, rezulton së Njësia e Personelit të Komunës së Pejës, me rastin e përfshirjes së kandidates fituese në listën e verifikimit paraprak, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret e konkursit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: **7.Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;** dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: “ **Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.**

Rrjedhimisht, duke qenë së në procedurën e kontestuar ka pas vetëm një kandidat të suksesshëm gjegjësisht kandidaten V.G, e cila sipas konstatimit si më sipër nuk ka plotësuar kriterin e fushës së arsimit, e duke qenë së Kolegji nuk ka gjetur shkelje të cilat kanë cenuar ndonjë të drejtë të ankueses në fazën e verifikimit paraprak apo testit më shkrim, atëherë, në kuptim të kthimit të ligjshmërisë Kolegji aprovoj ankesën si të bazuar dhe anuloi në tërësi procedurën e kontestuar.

Thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1314/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Q.K;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.